



### **VENDIM**

***Nr. 79 Datë 15.06.2012***

### **PER**

### **MIRATIMIN E DOKUMENTIT “FTESE PER SHPREHJE INTERESI” QE DO TE SHPALLET NGA TAP AG NE PERPUTHJE ME UDHEZUESIN PËR MENAXHIMIN DHE ALOKIMIN E KAPACITETEVE TË PROJEKTIT TRANS ADRIATIK PIPELINE (TAP), SIPAS PARAGRAFIT 6, TË NENIT 36 TË DIREKTIVËS 2009/73/EC**

Në mbështetje të nenit 40, të Ligjit nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe neni 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin nr. 107, datë 17.10.2011 të Bordit të Komisionerëve, vendimin nr 155, datë 19.12.2011, për fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për përjashtimin nga akses i palëve të treta të paraqitur nga ana e kompanisë TAP AG, neni 3 të Udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në Projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP) të miratuar me vendimin nr. 39, date 23.04.2012 të Bordit të Komisionerëve, duke marre parasysh gjithashtu qe:

- Direktiva 2009/73/EC është e zbatueshme për Italinë dhe Greqinë, si Shtete Anëtare të Bashkimit European dhe është transpozuar në legjislacionin përkatës kombëtar të këtyre vendeve, dhe
- Direktiva 2003/55/EC është e zbatueshme për Shqipërinë si Palë Kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është transpozuar në legjislacionin kombëtar.
- Këshilli i Ministrave të Komunitetit të Energjisë ka vendosur më 6 tetor, 2011, që Direktiva 2009/73/EC dhe Rregullorja 715/2009, do të duhet të zbatohen nga të gjitha Palët Kontraktuese brenda vitit 2015.
- Neni 22, i Direktivës 2003/55/EC, Neni 36 i Direktivës 2009/73/EC dhe legjislacioni kombëtar, kërkojnë që në rastin kur infrastruktura në fjalë shtrihet në territorin e me shume së një vendi, çdo vendim për përjashtim

prej të drejtës së aksesit te palëve te treta, (TPA) duhet të merren në bashkëpunim mes Autoriteteve Kombëtare të vendeve përkatëse.

- Neni 3, i Udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në Projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP) të miratuar me Vendimin nr. 39, date 23.04.2012, të Bordit të Komisionerëve, ka përcaktuar detyrimin e miratimit nga ana e Autoriteteve Rregullatore, te dokumentit “Ftese per shprehje interesi”, që do te shpallet nga TAP AG, në përputhje me Udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatik Pipeline (TAP).

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.06.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi punes, në lidhje me dokumentin “Ftese per shprehje interesi” që do te shpallet nga TAP AG, në përputhje me Udhëzuesin për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të projektit Trans Adriatik Pipeline (TAP) sipas paragrafit 6, të nenit 36 të Direktivës 2009/73/EC, që ka rezultuar prej bashkëpunimit të tre rregullatorëve,

### **Vendosi:**

1. Miratimin e dokumentit “Ftesë për Shprehje Interesi” qe do te shpallet nga TAP AG ne përputhje me Udhëzuesin për Menaxhimin dhe Alokimin e Kapaciteteve në Projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6, të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC (Bashkëlidhur këtij Vendimi, Dokumenti “Ftese per Shprehje Interesi”).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

### **KRYETARI**

**Sokol RAMADAN**

